

KONTRATE DHURIMI

KUOTE

Sot me datën 04.10.2020 (dymijë e njëzete), në Tiranë, lidhet kjo Kontratë Dhurimi (në vijim referuar si “Kontrata”), ndërmjet palëve si vijon:

DHURUESI: ELTON KUKA, shtetas shqiptar, lindur me 28.07.1976, ne Tiranë dhe banues ne Tirane, mbajtës i pasaportës me nr. SB2175224, person madhor me zotësi te plote juridikë për te vepruar.

(në vijim referuar si “Dhuruesi”)



PRANUESI I DHURIMIT: SAIMIR BOKA, shtetas shqiptar, lindur më 22.02.1980, ne Tiranë dhe banues në Tiranë mbajtës i letërnjoftimit me nr. 034151223, person madhor me zotësi te plote juridikë për te vepruar.

(në vijim referuar si “Pranuesi i Dhurimit”)

Këtu e në vijim Dhuruesi dhe Pranuesi i Dhurimit do të referohen individualisht si “Palë” dhe së bashku si “Palët”.

PARASHTRIMET:

1. Shoqëria “GR ALBANIA” sh.p.k., është një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, regjistruar ne regjistrin tregtar, te mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me Numër Unik Identifikimi të Subjekti (NUIS): L01509004N, me seli ne adresën: Rruga “Sami Frasheri”, Ndërtesa Nr. 19, Hyrja Nr. 8 (në vijim referuar si “Shoqëria”)
2. Bazuar ne Ekstraktin e Shoqërisë, kapitali i saj është 100.000.000,00 (njëqind milion) Lekë i ndarë si vijon:
 - a. Gentjan Filaj, zotërues i 715.400,00 (shtatë qind e pesëmbëdhjetë mijë e katërqind) pjesëve/kuotave të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë nominale 35.770.000,00 (tridhjetë e pesë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë mijë) Lekë, qe i korrespondojnë 35,77 (tridhjetë e pesë presje shtatëdhjetë e shtatë) % të kapitalit të Shoqërisë;
 - b. Henri Aleks, zotërues i 228.000,00 (dyqind e njëzet e tetë mijë) pjesëve/kuotave të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë nominale 11.400.000,00 (njëmbëdhjetë milion e katërqind mijë) Lekë, qe i korrespondojnë 11,40 (njëmbëdhjetë presje dyzetë) % të kapitalit të Shoqërisë;




- c. Elton Kuka, zotërues i 260.000,00 (*dyqind e gjashtëdhjetë mijë*) pjesëve/kuotave të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë nominale 13.000.000,00 (*trembëdhjetë milion*) Lekë, që i korrespondojnë 13,00 (*trembëdhjetë*) % të kapitalit të Shoqërisë;
 - d. Ahmet Burak Göktepe, zotërues i 100.000,00 (*një qind mijë*) pjesëve/kuotave të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë nominale 5.000.000,00 (*pesë milion*) Lekë, që i korrespondojnë 5,00 (*pesë*) % të kapitalit të Shoqërisë;
 - e. Realdo Mansaku, zotërues i 696.600,00 (*gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind*) pjesëve/kuotave të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë nominale 34.830.000,00 (*tridhjetë milion e tetëqind e tridhjetë mijë*) Lekë, që i korrespondojnë 34,83 (*tridhjetë e katër presje tetëdhjetë e tre*) % të kapitalit të Shoqërisë.
3. Dhuruesi siç përshkruhet edhe me sipër, është ortak i Shoqërisë dhe zotërues i 260.000,00 (*dyqind e gjashtëdhjetë mijë*) pjesëve/kuotave të kapitalit, me vlerë nominale 13.000.000,00 (*trembëdhjetë milion*) Lekë, që i korrespondojnë 13 (*trembëdhjetë*) % të kapitalit të saj.
 4. Dhuruesi ka përfituar 260.000,00 (*dyqind e gjashtëdhjetë mijë*) nëpërmjet dy transaksioneve në vitin 2016. Konkretisht:
 - a. Me Kontrate Dhurimi Nr. 793 Rep., Nr.449 Kol., date 18.02.2016 janë transferuar 130.000,00 (*njëqind e tridhjetë mijë*) pjesë/kuota të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë nominale 6.500.000,00 (*gjashtë milion e pesëqind mijë*), që i korrespondon 6,5 (*gjashtë presje pesë*) % të kapitalit të saj.
 - b. Me Kontrate Dhurimi Nr. 1237 Rep., Nr. 719 Kol., date 21.03.2016 janë transferuar 130.000,00 (*njëqind e tridhjetë mijë*) pjesë/kuota të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë nominale 6.500.000,00 (*gjashtë milion e pesëqind mijë*), që i korrespondon 6,5 (*gjashtë presje pesë*) % të kapitalit të saj.
 5. Ortaku i Shoqërisë Z. Elton Kuka, Dhuruesi dëshiron t'i dhurojë pa asnje kusht pjesët/kuotat që ai zotëron në kapitalin e Shoqërisë Pranuesit të Dhurimit Z. Saimir Boka.
 6. Pranuesi i Dhurimit nga ana tjetër pranon dhurimin e bërë nga z. Elton Kuka dhe shprehet se dëshiron të behet pronar i pjesëve/kuotave që Dhuruesi zotëron tek Shoqëria.
 7. Dhënësja e pëlqimit është në dijeni të transaksionit dhe deklaron se është dakord me vazhdimin e tij. Dhënësja e pëlqimit pohon me vetëdije të plotë se pranon që kuotat që bashkëshorti i saj zotëron në Shoqëri të dhurohen z. Saimir Boka

PËR KËTË ARSYE, në përputhje me sa më sipër, Palët bien dakord që të lidhin këtë Kontratë, sipas kushteve dhe afateve të mëposhtme:

NENI 1

PARASHTRIMET, SHTOJCAT DHE INTERPRETIMI

1.1 Parashtrimet/Shtojcat



Parashtrimet dhe dokumentet bashkëngjitur janë pjesë përbërëse e kësaj Kontrate dhe do të interpretohen sipas kuptimit të këtij neni.

1.2 Interpretimi

Përveç se kur konteksti i kësaj Kontrate kërkon ndryshe:

(i) fjalët e secilës gjini do të përfshijnë edhe gjininë tjetër;

(ii) termat "të kësaj", "këtu", "nëpërmjet kësaj ose nga kjo", "në këtë" dhe fjalë të ngjashme i referohen Kontratës në tërësi dhe jo ndonjë Neni, Paragrafi, Bashkëlidhje apo ndonjë nënndarje tjetër të kësaj Kontrate;

(iii) Parashtrimet, Shtojcat, dhe Bashkëlidhjet e kësaj Kontrate do të përbëjnë pjesë integrale të saj dhe referencat në Shtojcat dhe Bashkëlidhjet do të jenë referenca në Shtojcat dhe Bashkëlidhjet e kësaj Kontrate, përveç kur Palët merren vesh ndryshe.

(iv) referencat në ndonjë akt përfshijnë çdo ndryshim ose ri-nxjerrjeje të atij akti, si dhe çdo rregull ose rregullore të nxjerrë në zbatim të këtij akti; dhe referenca në një ligj do të thotë referencë në një ligj të tillë, siç mund të jetë ndryshuar, rinxjerrë apo ribërë;

(v) fjalët "përfshin" ose "duke përfshirë" do të konsiderohet se pasohen nga "pa kufizim" ose "duke mos u kufizuar në", edhe nëse ato ndiqen ose jo nga fraza ose fjalë të tilla të ngjashme;

(vi) referencat në "kjo kontratë" ose në çdo marrëveshje ose dokument tjetër do të interpretohen si referenca në këtë kontratë ose dokument, të ndryshuar, modifikuar, ose shtuar dhe që janë në fuqi nga koha në kohë, si dhe do të përfshijnë referencën në çdo dokument që e ndryshon, modifikon ose e shton atë dokument, ose që është lidhur, bërë ose dhënë në zbatim ose në përputhje me kushtet e saj;

(vii) sa herë që kjo Kontratë i referohet një numri "ditësh" ky numër do t'i referohet ditëve kalendarike, përveç kur shprehimisht specifikohen si Ditë Pune;

(viii) titujt e Neneve, Kapitujt dhe Nenet në këtë Kontratë janë bërë vetëm për qëllime lehtësimi dhe reference, dhe këto nuk do të ndikojnë në asnjë mënyrë në interpretimin e kësaj Kontrate.

NENI 2



OBJEKTI I KONTRATES

Objekt i kësaj Kontrate është transferimi me anë të dhurimit, të 260.000,00 (*dyqind e gjashtëdhjetë mijë*) pjesëve/kuotave që Dhuruesi zotëron në Shoqërinë "GR ALBANIA" SHPK, me vlerë nominale 13.000.000,00 (*trembëdhjetë milion*) Lekë, që i korrespondojnë 13,00 (trembëdhjetë) % të kapitalit të saj, tek z. Saimir Boka.

NENI 3

DEKLARIMET DHE GARANCITË

3.1 Deklarimet dhe Garancitë e Dhuruesit



(a) Pronar i Ligjshëm

Dhuruesi deklaron dhe garanton se është pronari i ligjshëm i pjesëve/kuotave të zotëruara prej tij në Shoqëri identifikuar në dokumentet bashkëngjitur dhe nuk ka asnjë pengesë ligjore, dhe/ose nuk i nevojitet asnjë tagër tjetër ligjor për të lidhur kete kontrate, dhe për te permbushur detyrimet që rrjedhin prej saj.

(b) Barrët mbi Pronën

Dhuruesi deklaron se pjesët/kuotat e zotëruar prej tij në Shoqëri, objekt i kësaj Kontrate nuk janë të ngarkuar me asnjë barrë, qoftë si peng, barrë siguruese apo barrë financiare (qofshin këto ligjore, gjyqësore apo kontraktore), apo të drejta të tjera të ngjashme me to, çdo e drejtë apo interes i dhënë me kontrate çdo personi, duke përfshirë çdo të drejtë blerje, opsioni ose të drejtë parablerje, dhënie përdorimi apo posedimi me kontrata të tjera, si dhe pa u kufizuar në to, çdo transaksion, veprim juridik a kufizim ligjor tjetër, përfshi këtu çdo vendim gjyqësor, përfundimtar apo të ndërmjetëm, vendim përbarimor, apo të autoriteteve të tjera përcaktuar me ligj, i tillë që do të cenonte titullin e pronësisë së Pranuesi i Dhurimit mbi pjesët/kuotat objekt të transferimit sipas kësaj Kontrate.

(ç) Garancia

Në bazë të njohurive më të mira të Dhuruesit, në datën e lidhjes së kësaj Kontrate nuk ekzistojnë pretendime nga të tretët, çështje gjyqësore në gjykim, të pezulluara ose të mundshme, pretendime ose vendime gjyqësore a masa sigurimi në lidhje me çdo pjesë/kuotë objekt të transferimit sipas kësaj Kontrate dhe asnjëra prej këtyre padive, proceseve gjyqësore, masave dhe pretendimeve nuk ka të ngjarë të ndodhë; Të gjitha deklaramet dhe garancitë e Dhuruesit të paraqitura me sipër janë të verteta dhe të sakta.

3.2 Detyrimet e Dhuruesit

(a) Nënshkrimi i Akteve



Dhuruesi merr përsipër dhe detyrohet të nënshkruajë çdo akt e të kryejë çdo veprim juridik pa vonesa, kur i kerkohet nga Pranuesi i Dhurimit, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me pjesët/kuotat objekt transferimi sipas kësaj Kontrate, e që mungesa e të cilit do të pengonte ushtrimin e plote, të pakushtëzuar e të pakufizuar prej Dhuruesit të të drejtës së tij të pronësisë mbi këto pjesë/kuota.

(b) Mbrojtja Gjyqësore

Në rastin kur një palë e trete (përfshi autoritetet publike) ngre pretendime dhe/ose ben ankime gjyqësore për të kundërshtuar titullin e pronësisë të Pranuesi i Dhurimit mbi pjesët/kuotat objekt të transferimit sipas kësaj Kontrate, ose duke u bazuar në pretendime të mëparshme cenon apo kundërshton të drejtat që burojnë nga këto pjesë/kuota, Dhuruesi merr përsipër dhe detyrohet të thirret/ndërhyjë në gjykimin e çështjes, dhe me shpenzimet e tij të mbroje interesat e Pranuesi i Dhurimit si të ishin të tijat.

(c) Cenimi i Titullit

Pa kufizuar të drejtat e tjera të Pranuesi i Dhurimit të përcaktuar me ligj, Dhuruesi merr përsipër dhe detyrohet të mbrojë, zhdëmtojë, dëmshpërblejë, dhe ruajë Pranuesi i Dhurimit, ndaj dhe në



vlerën e plotë të: (i) çdo detyrimi, dëmi, humbjeje, apo shpenzimi, përfshi këtu shpenzimet e avokatit apo të ekspertëve të Dhuruesit që rezultojnë nga dokumente zyrtare (kontrata, fatura), të pasur nga Pranuesi i Dhurimit për t'u mbrojtur nga çdo pretendim, kërkesë, apo padie, proces a vendim gjyqësor, përmbarimor të një të treti (për qëllimet e këtij neni, i tretë quhen edhe autoritetet publike kur veprojnë në rastet e parashikuara me ligj) që duke u hequr si pronar i ligjshëm, kundërshton titullin e pronësisë të Pranuesi i Dhurimit mbi pjesët/kuotat objekt transferim sipas kësaj Kontrate.

NENI 4

MOSPËRMBUSHJA E DETYRIMEVE

Pa u cenuar të drejtat e tjera sipas legjislacionit në fuqi apo kësaj Kontrate, nëse Dhuruesi nuk përmbush detyrimet kontraktore të marra përsipër, dhe nuk rregullon situatën nëse kjo është e mundshme, Pranuesi i Dhurimit ka të drejtë në çdo rast të t'i kërkojë Dhuruesit vlerën e tregut të pjesëve/kuotave objekt të transferimit sipas kësaj Kontrate dhe të shpërblehen për dëmin e pësuar nga mospërmbushja e detyrimeve të Dhuruesit.

NENI 5

TË NDRYSHME

5.1 Marrëveshja e Plotë

Kjo Kontratë, duke përfshirë Parashtrimet dhe Shtojcat bashkëngjitur saj, përbën tërësinë e marrëveshjes së lidhur ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e saj, dhe zëvendëson çdo ose të gjitha kontratat, marrëveshjet e mëparshme apo mirëkuptimet, me gojë ose me shkrim, ndërmjet Palëve në lidhje me kuotat objekt të transferimit sipas kësaj Kontrate. Çdo shtesë apo ndryshim i kësaj Kontrate duhet të kryhet me shkrim dhe të miratohet nga palët përndryshe do të konsiderohet e pavlefshme.

5.2 Vecueshmeria e Kontratës

Nëse ndonjë kusht apo dispozite e kësaj Kontrate shpallet e pavlefshme dhe/ose e paligjshme dhe/ose e pazbatueshme, dispozitat e tjera të Kontratës, për sa është e mundur nuk do të ndikohen prej kësaj pavlefshmëria. Në këto raste, Palet në mirëkuptim do të mundohen të zëvendësojnë pa vonesa dispozitat e pavlefshme, me dispozita të vlefshme, me qëllim përmbushjen e objektit të kësaj Kontrate.

5.3 Njoftimet

a Çdo njoftim ose komunikim tjetër nga njëra Palë te Pala tjetër, i cili kërkohet ose lejohet të bëhet sipas dispozitave të kësaj Kontrate do të:

(i) bëhet në gjuhën shqiptare;

(ii) bëhet me shkrim;



(iii) dërgohet personalisht (dorazi) ose dërgohet me anë të postës së regjistruar me parapagim ose me poste te shpejte në adresën e Palës tjetër, e cila është paraqitur më poshtë ose në ndonjë adresë tjetër të cilën do ta kërkojë me anë njoftimi Pala tjetër, dhe

(iv) shënohet në vëmendje të personit(ave) të përcaktuar më poshtë ose të person(ave) të tjerë të tillë që mund t'i kërkojë me anë njoftimi Pala tjetër.

- b Për efekt njoftimi sipas klauzolës së mësipërme (a) të këtij neni, palët deklarojnë adresat e poshtëshënuara:

Për Dhuruesin:

Në vëmendje të: Z. Elton Kuka

Adresa: Rruga "Elbasanit", Pall. Edil-al, Hyrja 10, AP 4F, Tiranë

Telefon: 00 355 68 20 90 111

E-mail: toni.kuka@gmail.com

Për Pranuesi i Dhurimit:

Në vëmendje të: Z. Saimir Boka

Adresa: Rruga "Zef Jubani", pallati 31, Shkalla 1 Tirane

Telefon: 00 355 69 40 20 432



E-mail: saimirboka@gmail.com

- c Çdo njoftim ose komunikim tjetër i bërë nga njëra Palë te tjetra, në përputhje me dispozitat e mësipërme të këtij Neni, do të konsiderohet se është marrë nga Pala tjetër nëse është dërguar dorazi në ditën që është lënë në adresën e mëposhtme të palës tjetër (siç mund të ndryshohet herë pas herë me njoftimin e arsyeshëm të kryer nga secila Palë te Pala tjetër), nëse është dërguar me anë të postës së regjistruar me parapagim ose me postë te shpejte dyzet e tetë orë (48) nga data e postimit, ose nëse është dërguar me faks, siç është parashikuar më sipër, në adresat e deklaruara prej palëve.

NENI 6

EFEKTE LIGJORE

- 6.1 Palët bien dakord se me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Pranuesi i Dhurimit bëhet pronar me të drejta të plota të pjesëve/kuotave të blera, sipas përcaktimit të Objektivit të kësaj Kontrate, si më sipër, dhe Dhuruesi zhvishet nga çdo e drejtë lidhur me këto pjesë/kuota.
- 6.2 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, pjesëmarrja në Shoqëri do të jetë si më poshtë:
- Z. Elton Kuka, largohet nga Shoqëria.
 - Z. Saimir Boka, bëhet zotëruar i 260.000,00 (dyqind e gjashtëdhjetë mijë) pjesëve/kuotave të kapitalit, që i korrespondojnë 13 (trembëdhjetë) % te kapitalit të saj;



- Z. Gentjan Filaj, mbetet zotërues i 715.400,00 (*shtatëqind e pesëmbëdhjetë mijë e katërqind*) pjesëve/kuotave të kapitalit të shoqërisë;
 - Z. Henri Aleksi, mbetet zotërues i 228.000,00 (*dyqind e njëzet e tetë mijë*) pjesëve/kuotave të kapitalit të shoqërisë;
 - Z. Ahmet Burak Göktepe, mbetet zotërues i 100.000,00 (*një qind mijë*) pjesëve/kuotave të kapitalit të Shoqërisë;
 - Z. Realdo Mansaku, mbetet zotërues i 696.600,00 (*gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind*) pjesëve/kuotave të kapitalit të Shoqërisë.
- 6.3 Pranuesi i Dhurimit merr përsipër, që do të kryejë të gjitha veprimet përkatëse për të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (“**QKB**”) këtë Kontratë dhe ndryshimet përkatëse në pjesëmarrjen e kapitalit të Shoqërisë sipas pikës 2 të këtij neni të Kontratës.

NENI 7

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 7.1 Nëse midis palëve do të lindë ndonjë mosmarrëveshje në lidhje me zbatimin apo interpretimin e kësaj Kontrate (*në vijim referuar si “Mosmarrëveshje”*), secila nga Palët do t'i japë Palës tjetër njoftim me shkrim në lidhje me këtë Mosmarrëveshje, duke parashikuar shkaqet e mosmarrëveshjes. Pas njoftimit Palët do të takohen menjëherë dhe do të përpiqen me mirëbesim të arrijnë një zgjidhje me pajtim në përputhje me legjislacionin shqiptar për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.
- 7.2 Nëse nuk arrihet një zgjidhje me pajtim në përputhje me sa më sipër brenda 15 (*pesëmbëdhjetë*) ditëve nga marrja e njoftimit të parashikuar më sipër, çdo Mosmarrëveshje do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Seksioni Civil.

NENI 8


DISPOZITAT E FUNDIT

Kjo Kontratë hartohet ne 3 (*tre*) kopje me vlerë të njëjtë juridike.

Palët pasi lexuan Kontratën bien dakord me sa është përcaktuar më sipër dhe konfirmojnë se ajo është përpiluar ne përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të pavesuar.

DHURUESI

ELTON KUKA



PRANUESI I DHURIMIT

SAIMIR BOKA

